



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 Tetor 2016
Nr. ref.: RK984/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI151/15

Parashtrues

Ol. S. dhe Olt. S.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 186/2015, të 6 korrikut 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga të miturit Ol. S. dhe Olt. S. nga Gjilani (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit përfaqësohen nga avokatët Mexhid Syla dhe Blerim Syla, në bazë të autorizimit të dhënë avokatëve nga babai i parashtruesve të kërkesës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 186/2015, të 6 korrikut 2015, i cili u është dorëzuar atyre më 26 gusht 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 dhjetor 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 27 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 1 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga përfaqësuesi i tyre ligjor që të precizojë kërkesën.
8. Njëkohësisht, Gjykata kërkoi nga parashtruesit të dorëzojnë një kopje të fletëkthesës, e cila tregon se kur u është dorëzuar atyre Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 186/2015, i 6 korrikut 2015.
9. Më 9 shkurt 2016, parashtruesit dorëzuan në Gjykatë informatat e kërkuara, duke konfirmuar se parashtruesit e kërkesës janë të miturit: Ol. S. dhe Olt. S.
10. Përveç kësaj, parashtruesit dorëzuan edhe një kopje të fletëkthesës, e cila tregon se atyre u ishte dorëzuar aktgjykimi i lartpërmendur më 26 gusht 2015.
11. Më 12 shkurt 2016, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
12. Më 15 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 30 gusht 2010, parashtruesit ishin duke udhëtuar me veturë, së bashku me prindërit dhe me vëllain e tyre.
14. Në autostradën Durrës-Kukës në Shqipëri, ndodhi një aksident për shkak të shpërthimit të një gome të automjetit të tyre, i cili më pas goditi një automjet tjetër të parkuar pranë rrugës.
15. Nëna dhe vëllai i parashtruesve të kërkesës humbën jetën menjëherë në vendin e ngjarjes, ndërsa parashtruesit dhe babai i tyre morën lëndime të rënda trupore.
16. Automjeti kishte një policë të vlefshme të sigurimit për automjete nga Kompania e Sigurimeve "Sigal Uniqua Group" nga Prishtina (në tekstin e mëtejshëm: Kompania e Sigurimeve).
17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për kompensimin e dëmit nga Kompania e Sigurimeve.
18. Kompania e Sigurimeve refuzoi tërësisht kërkesën për kompensimin e dëmit.
19. Më 23 nëntor 2010, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Komunale të Gjilanit.
20. Në këto procedura, parashtruesit e kërkesës ishin paditës së bashku me babanë e tyre dhe me prindërit e nënës së tyre të vdekur.
21. Më 8 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Gjilan (Aktgjykimi C nr. 586/2010) e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë, duke detyruar të paditurin që t'ua kompensojë paditësve dëmin e shkaktuar.
22. Gjykata Komunale konstatoi se aksidenti ishte shkaktuar nga një send i rrezikshëm dhe se automjeti kishte policë të vlefshme të sigurimit nga kompania e sigurimeve. Si pasojë e aksidentit, parashtruesit e kërkesës përjetuan dhimbje fizike, frikë dhe aktivitet të zvogëluar jetësor. Sipas Gjykatës Komunale, parashtruesit gjithashtu kishin përjetuar ankth shpirtëror për humbjen e familjarëve të tyre.
23. Kundër këtij aktgjykimi, të dyja palët parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit. Paditësit (parashtruesit e kërkesës) në ankesën e tyre pretenduan aplikimin e gabuar të së drejtës materiale në lidhje me shumat e gjykuara për kompensim, ndërsa Kompania e Sigurimeve, si palë e paditur, e kontestoi në tërësi bazën juridike.
24. Më 18 shkurt 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 5087/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e Kompanisë së Sigurimeve, ndërsa aprovoi pjesërisht ankesën e paditësve duke i rritur shumat e gjykuara.
25. Më 13 mars 2015, Kompania e Sigurimeve parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se

Aktgjykimi përmbante zbatim të gabuar të së drejtës materiale, posaçërisht duke theksuar si në vijim:

“Pasi që kemi të bëjmë me aksident komunikacioni mes dy automjeteve të cilat kanë qenë nga dy shtete të ndryshme atëherë për gjykimin e çështjes së kompensimit të dëmit ka qenë dashur të zhvillohet procedura gjyqësore në vendin ku ka ndodhur aksidenti-dëmi”.

26. Më 6 korrik 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 186/2015) e miratoi revizionin e Kompanisë së Sigurimeve dhe i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, duke refuzuar në tërësi padinë e parashtruesve të kërkesës, me arsyetim se *“sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësisë mbulon territorin e Kosovës”* dhe se për kontestet që kanë ndodhur jashtë territorit të Kosovës janë kompetente gjykatat e vendit ku ka ndodhur ngjarja.
27. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ka mbajtur qëndrimin se gjykatat në Republikën e Shqipërisë ishin kompetente për të gjykuar këtë çështje civile-juridike.
28. Sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, në bazë të një Memorandumi të Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejme: MiM), të nënshkruar ndërmjet Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimeve-Tiranë (AIB), gjykatat e Kosovës nuk kishin juridiksion për të gjykuar këtë kontest.
29. Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme, konstatoi:

“[Gjykatat e instancës më të ulët drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike, por në bazë të gjendjes së tillë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar. Kjo nga fakti se në bazë të nenit 1 pika 1.5 të Rregullës 3 mbi Ndryshimin e Rregullës për Sigurimin e Detyrueshëm të autopërgjegjësisë së BQK, sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësisë mbulon territorin e Kosovës.

Më datë 31.10.2006, Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK), si entitet i autorizuar nga misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për çështjet e sigurimit të automjeteve nga Byroja Shqiptare e Sigurimit-Tiranë (AIB) si entitet i autorizuar, përgjegjës për çështjen e sigurimit të automjeteve, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit. Në Kreun III, i cili rregullon trajtimin dhe pagesat e kërkesave për zhdëmtim në pikën 3 është paraparë se MOU, do të përfshijë raportimin, trajtimin dhe pagesat e kërkesave për zhdëmtim për lëndime personale si dhe për humbje apo dëmtim të pasurisë (a) që kanë ndodhur si pasojë e ndonjë aksidenti në Republikën e Shqipërisë, të shkaktuar nga automjetet e siguruara të regjistruara në Kosovë. Në pikën 1 të Kapitullit III të Memorandumit për Mirëkuptim, është paraparë që secila palë do të trajtojë dhe do të paguajë kërkesat për zhdëmtim që janë adresuar nga pala tjetër në kuadër të MOU, në pajtim me kapitullin IV të Memorandumit, respektivisht në interes të anëtarit

sigurues sikur ai të ketë lëshuar certifikatën e sigurimit dhe në përshtatje me dispozitat ligjore në fuqi, brenda territorit të vet.

Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar dhe në bazë të nenit 224, par. 1 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës ndahen si vijon:
- A. Pretendimet në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë [Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së];
 - B. Pretendimet në lidhje me shkeljen e parimit të barazisë para ligjit [Neni 24 i Kushtetutës];
 - C. Pretendimet në lidhje me shkeljen e mbrojtjes së pronës [Neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Pretendimet në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë

31. Parashtruesit pretendojnë se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e tyre për gjykim të drejtë, për shkak se Gjykata Supreme nuk ka dhënë një arsyetim të pranueshëm në vendimin e saj dhe me këtë nuk ka garantuar një procedurë të drejtë të çështjes në pajtim me nenin 6.1 të KEDNJ-së. Sipas parashtruesve të kërkesës, arsyetimi i vendimit duhet të reflektojë një marrëdhënie adekuate të gjetjeve - situatës faktike, provave dhe konkluzioneve që dalin nga dispozitat ligjore përkatëse.
32. Sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës:
- “Gjykata Supreme jo vetëm që nuk ka ofruar arsyetim konkret se ku qëndron zbatimi i gabuar i të drejtës materiale në vendimet e gjykatave më të ulëta por në vendimin e saj mungon një arsyetim konkret lidhur me nenet për të cilat kjo gjykatë pretendon se janë shkelur me aktgjykimet. Në fakt gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se për çfarë arsye nuk mund të zbatohet neni 47 paragrafi 2 i Ligjit të Procedurës Kontestimore, me të cilin është përcaktuar kompetenca territoriale e gjykatës kompetente për të gjykuar rastet kur kemi të bëjmë me dëme që janë shkaktuar për shkak të vdekjes apo lëndimit të rëndë trupor. Që në rastin konkret kjo kompetencë bie në ish Gjykatën Komunale në Gjilan”.*
33. Më tej, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:
- “Me këtë aktgjykim, Gjykata Supreme nuk ka bërë përpjekje të duhura për të analizuar pretendimet e parashtruesve në të gjitha çështjet e ngritura juridike, [...] kjo gjetje e Gjykatës Supreme është në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPK-së dhe po ashtu edhe me vetë MOU-në”.*
34. Sipas parashtruesve të kërkesës, Gjykata Supreme duhet të ketë marrë parasysh se MiM ka karakterin e një marrëveshje të mirëkuptimit dhe se nuk mund të ketë prioritet mbi ligjet pozitive të një shteti.

35. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, u jep parashtruesve të drejtë për të pasur qasje dhe për të shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike, të cilat janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Prandaj, parashtruesit pretendojnë se është shkelur e drejta e tyre për qasje në gjykatë.

Pretendimet në lidhje me shkeljen e parimit të barazisë

36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, me vendimin e saj, Gjykata Supreme ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, sipas nenit 24 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, ata pretendojnë se refuzimi i mundësisë për të ushtruar të drejtat e tyre para instancave gjyqësore të Kosovës, vetëm për shkak se aksidenti ka ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të qartë paraqet shkelje të barazisë para ligjit.

Pretendimet në lidhje me shkeljen e mbrojtjes së pronës

37. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, për shkak të dështimit për të arsyetuar shkaqet e refuzimit të padisë së tyre, përkatësisht juridiksionin e gjykatave në Kosovë për gjykimin e këtij kontesti, ishte shkelur e drejta e tyre për kompensim.

Kërkesa e parashtruesve

38. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Rev. nr. 186/2015, të 6 korrikut 2015) dhe ta vërtetojë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 5087/2012, të 18 shkurtit 2015).

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës, parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

41. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

42. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

dhe

(2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

43. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] dhe me nenin 1 të Protokollit 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së.

Pretendimet në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë

44. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës se Gjykata Supreme e Kosovës ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe MiM, Gjykata thekson se zbatimi i të drejtës materiale është kompetencë e gjykatave të rregullta.

45. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

46. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (shih Raportin e Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

47. Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban të gjitha arsyet e nevojshme mbi të cilat është bazuar. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës, neni 6 nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument që i ofrohet gjykatës gjatë mbajtjes së procedurës (Shih rastin *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 prillit 1994, para. 61).

48. Prandaj, Gjykata konstaton se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe në pajtim me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

Pretendimet në lidhje me shkeljen e parimit të barazisë para ligjit

49. Gjkata vëren se parashtruesit thirren edhe në nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe pretendojnë se është shkelur parimi i barazisë për shkak të refuzimit të mundësisë për të ushtruar të drejtat e tyre nëpërmjet instancave gjyqësore të Kosovës, vetëm për shkak se aksidenti ka ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.
50. Gjkata konstaton se parashtruesit nuk kanë treguar se janë trajtuar ndryshe në krahasim me mënyrën se si do të ishin trajtuar individë të tjerë në të njëjtën situatë. Në mënyrë që një çështje të jetë diskriminuese duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata të ngjashme. Një ndryshim i trajtimit është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, me fjalë të tjera, në qoftë se ajo nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet. (Shih rastin *Burden kundër MB* [DHM] nr. 13378/05, GJEDNJ, Aktgjykim i 29 prillit 2008).
51. Gjkata konstaton se parashtruesit nuk kanë paraqitur ndonjë fakt dhe as nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre për trajtim të pabarabartë. Kur pretendohet një shkelje e tillë kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe argument bindës.

Pretendimet në lidhje me shkeljen e mbrojtjes së pronës

52. Gjkata vëren se parashtruesit gjithashtu thirren në nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Megjithatë, nuk ka asgjë në pretendimin e parashtruesve që arsyeton përfundimin se është shkelur e drejta e tyre kushtetuese në pronë.
53. Gjkata rikujton se neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk garantojnë të drejtën për fitimin e pronës (shih, *Van der Musselle kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983; *Slivenko dhe të tjerët kundër Lituanisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 tetorit 2003).
54. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me “pasurinë” e tyre; në kuptim të kësaj dispozite “pasuritë” mund të jenë “pasuritë ekzistuese”, duke përfshirë pretendimet në lidhje me të cilat parashtruesit mund të argumentojnë se ata kanë të paktën një “pritshmëri legjitime” se ata do të fitojnë gëzimin efektiv të së drejtës së pronësisë.
55. Nuk mund të thuhet se çdo “pritshmëri legjitime” lind kur ka një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e duhur dhe zbatimin e ligjit të brendshëm dhe ku parashtrimet e parashtruesve janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, i 28 shtatorit 2004).

56. Si përmbledhje, Gjykata ripërsërit se është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
57. Gjykata sqaron se nuk është detyrë e saj të shqyrtojë nëse Gjykata Supreme ka interpretuar drejt ligjet dhe aktet nënligjore relevante lidhur me juridiksionin e gjykatave të rregullta, pasi që kjo hyn në sferën e ligjshmërisë. Është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të konstatojë nëse aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka cenuar të drejtat dhe liritë e individit të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
58. Në këtë drejtim, edhe pse parashtruesit pretendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ata nuk kanë dëshmuar pretendimin se vendimet e lartcekura kishin shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.
59. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtruesve, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ata e kundërshtojnë janë të paraqitura në mënyrë të detajuar dhe se, në bazë të asaj që u tha më lart, procedura pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishte e drejtë.
60. Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Parashtruesit e kërkesës nuk arritën t'i vërtetojnë pretendimet e tyre se me vendimin e kontestuar u janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.
61. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores se punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi